LIGJ
Nr.10 053, datë 29.12.2008

PËR NJË SHTESË NË LIGJIN NR.7961, DATË 12.7.1995 "KODI I PUNËS I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 81 pikat 1 e 2 shkronja "d" dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr.7961, datë 12.7.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, bëhet shtesa si më poshtë:

Neni 1

Pas nenit 10 shtohet neni 10/1 me këtë përmbajtje:

"Neni 10/1
Mbrojtja për punonjësit që denoncojnë korrupsionin

1. Çdo masë ose sanksion administrativ i pajustifikuar, që është marrë ndaj punonjësve, të cilët kanë arsye të dyshojnë për korrupsion e që këtë dyshim ua paraqesin personave përgjegjës ose autoriteteve kompetente, është i pavlefshëm.
2. Kundër vendimit të dhënë në mënyrë të pajustifikuar për shkakun e mësipërm, punonjësi ka të drejtën e ankimit në gjykatë.
3. Raportimi i fakteve, që kanë lidhje me korrupsionin, nuk përbën shkelje të detyrimit të sekretit profesional.".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.6011, datë 15.1.2009 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi